



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 07.02.2025

Nr: 71

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË DREJTORISË
VENDORE TË POLICISË LEZHË, PËR PERIUdhËN 26 JANAR-01 SHKURT 2025**

Sot, më datë 07.02.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë për periudhën 26 janar deri më 01 shkurt 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 26 janar-01 shkurt 2025, Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Rend Publik, “Më datë 31.1.2025 ora 14.00, do të zhvillohet analiza vjetore e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, ndër të cilët të ftuar do të jenë dhe Drejtues të Institucioneve të Pushtetit Vendor”, raportuar në datën 27.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 31.1.2025.

Data: 07.02.2025 Nr: 71
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, për periudhën 26 janar – 01 shkurt 2025”

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë ka marrë akses në llogarinë e raportimeve më datë 27.1.2025. Gjithashtu, aktiviteti i raportuar nuk është zhvilluar, si pasojë e angazhimeve të tjera zyrtare të Drejtuesve të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë dhe përfaqësuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”.*

Për sa më sipër, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstatova se veprimtaria e raportuar jashtë afatit nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, e cila ka marrë statusin “E Ndaluar” në NRI, nuk është zhvilluar. Në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI